



RREGULLORE PËR PROCEDURAT E NDARJES SË ÇMIMIT
“UKË BYTYÇI”

E MIRATUAR MË DATËN 29.09.2011

SHTATORË -2011

Ne bazë të neneve 12, 14 dhe 17, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, neneve 11, 15 dhe 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 77, të Ligjit për Procedurat Administrative, Nr-02/L-28, Vendimit të Kuvendit të Komunës në Suharekë, me numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011, Kuvendi Komunal në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën 29.09.2011, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E NDARJES SË ÇMIMIT “UKË BYTYÇI”

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi;

Neni 1.

Kjo Rregullore ka për qëllim që të rregullojë procedurat për ndarjen e çmimit **“Ukë Bytyçi”** dhe të përcaktoj kushtet, kriteret dhe prioritetin për ndarjen e këtij çmimi.

Neni 2.

Dhënia dhe ndarja e këtij çmimi është i përcaktuar përkatësisht me nenin 11, të Statutit të Komunës së Suharekës, dhe me Vendimin e Kuvendit të Komunës në Suharekë, me numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011.

Neni 3.

Çmimi **“Ukë Bytyçi”** për **Udhëheqje të mirë** jepet personaliteteve të gjallë, jo personave të vdekur (post mortum), të cilët kanë dhënë vlerat, rolin, kontributet dhe ndikimin e tyre në **Udhëheqje të mirë** (menaxhim) dhe i njëjti çmim jepet për çdo vit dhe atë në çdo përvjetor të vdekjes së ndjerit **“Ukë Bytyçit”**, konform Vendimit të Kuvendit të Komunës në Suharekë, me numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011.

Neni 4.

Çmimin e jep Kryetari i Komunës ose personi i deleguar (autorizuar) personalisht nga ai, konform, Vendimit të Kuvendit të Komunës në Suharekë, me numër, 01-Nr-16-887, të datës 23.02.2011.

Neni 5.

Ceremonia e dhënies së çmimit **“Ukë Bytyçit”**, organizohet nga Kryetari i Komunës, në një mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

Neni 6.

- 6.1** Të drejtën për të paraqitur propozime për ndarjen e çmimit **“Ukë Bytyçi”** e kanë; Kryetari i Komunës, institucionet shtetërore dhe publike, organizatat (shoqata) qeveritare dhe jo qeveritare, kryesit e fshatrave dhe çdo qytetar i Komunës së Suharekës.
- 6.2** Propozimi për ndarjen e çmimit është i plotë dhe shqyrtohet atëherë kur paraqitet me kohë dhe në vetë përmban një arsyetim të plotë dhe një CV-i për personin i cili propozohet.
- 6.3** Propozimi bëhet 2, (dy) muaj para ndarjes së çmimit, nëse propozimi nuk është i kompletuar si që kërkohet në pikën 2, të këtij neni, komisioni kërkon me shkrim, që brenda afatit prej 8, (tetë) ditësh nga dita e marrjes së njoftimit të bëhet plotësimi i propozimit, ose në të kundërtën llogarite se është hequr dorë nga propozimi i bërë.
- 6.4** Propozime nuk mund të bëhen për ata persona që janë të dënuar për shkelje të rënda të ligjit ose ndaj tyre është duke u zhvilluar procedura e hetimeve.
- 6.5** Procesi i shqyrtimit të propozimit apo momenti i dozimit të çmimit mund të shtyhet apo pezullohet, përkohësisht apo krejtësisht për rrethana të paparashikuara, që e dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të çmimit **“Ukë Bytyçi”** në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 7.

Të gjitha propozimet duhet të jenë të protokolluar për mes zyrës së pranimit dhe ti adresohen shërbimit të Kuvendit dhe zyrës së Kryetarit, i cili shërbim këto propozime ja kalon, Komisionit për shqyrtimin e propozimeve për procedurë të më tutjeshme, për të vendosur.

KRITERET, KUSHTET PËR NDARJEN E ÇMIMIT “UKË BYTYÇI”

Neni 9.

- 9.1** Kriteret në bazë të cilave caktohen prioritetet e dhënies së çmimit **“Ukë Bytyçi”**;
- 9.2** Udhëheqja e tij jetë e dalluar me kapacitetin, ndershmërinë, kulturën, transparencën, besimin, përgjegjësinë, guximin, vizionin, bashkëpunimin me anë të të cilave ka ndikuar në zhvillimin e vlerave njerëzore në organizatën e vet publike, private a joqeveritare duke u bërë kështu personalitet i admiruar nga komuniteti të cilit i takon.
- 9.3** Të jetë i pranueshëm dhe i njohur nga qytetarët-opinionit;
- 9.4** Udhëheqja e tij të dallohet apo të ketë vlera kombëtare;
- 9.5** Udhëheqja e tij të jetë e dalluar nga udhëheqja e zakonshme;
- 9.6** Gjatë udhëheqjes së tij të ketë ngjarje që i ka veçuar opinionit;

EMËRIMI I KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMEVE PËR NDARJEN E ÇMIMIT “UKË BYTYÇI”

Neni 10.

10.1 Komisioni për shqyrtimin e propozimeve për ndarjen e çmimit **“Ukë Bytyçi”**, emërohet nga Kuvendi i Komunës në Suharekë dhe duhet të jetë në përbërje prej **5 (pesë)**, anëtarëve, ku Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Suharekë, do të jetë edhe Kryesues i Komisionit, **2, (dy)**, anëtar të komisionit do të jenë anëtarë të Kuvendit të Komunës në Suharekë, **1 (një)** anëtarë do të jetë nga ekzekutivi dhe **1 (një)**, anëtar i komisionit mund të jetë jashtë legjislativit dhe ekzekutivit, nga shoqëria civile.

10.2 Mandati i komisionit përfundon me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, dhe pas formimit të Kuvendit të ri, formohet komision përsëri, konform dispozitave të kësaj rregullore.

10.3 Komisioni për shqyrtimin e propozimeve për ndarjen e çmimit **“Ukë Bytyçi”**, pas shqyrtimit të të gjitha propozimeve njërin nga të propozuarit ja rekomandon Kuvendit të Komunës për të vendosur dhe për ta shpallur fitues.

10.4 Vendimet e komisionit janë të vlefshëm nëse **pro** ose **kundërt** tyre votojnë shumica e anëtarëve të komisionit të pranishëm në mbledhje.

10.5 Në raste të numrit të barabartë të votave gjatë votimit **pro** ose **kundërt** një vendimi, vendimtare do të jetë vota shtesë e Kryesuesit të Komisionit.

10.6 Në raste se Komisioni pas shqyrtimit të të gjitha propozimeve, ka konstatuar se as njëri prej propozimeve nuk i plotëson kushtet dhe kriteret për ta fituar çmimin, komisioni vendos që mos të ndahet çmimi fare në atë vit.

Neni 11.

11.1 Komisioni për shqyrtimin e propozimeve për ndarjen e çmimit **“Ukë Bytyçi”**, punon në seanca dhe seancat janë publike (transparente) për qytetaret.

11.2 Kryesuesi i Komisionit thërret seancat, udhëheq ato dhe kujdeset për realizimin e konkluzave të miratuara, në mungesë të kryesuesit të komisionit, seancat i thërret dhe i udhëheq anëtari tjetër i komisionit i autorizuar nga ai.

11.3 Gjatë seancave mbahet procesverbal, procesverbali përmban konkluzat e marra, arsyetimin e secilit raste një nga një, vlerësimet e ndara nga anëtarët e komisionit nëse ka si dhe çështjet tjera të cilat i vlerëson komisioni futen në procesverbal dhe në fund nënshkruhet nga Kryesuesi i komisionit dhe procesmbajtësi.

11.4 Komisioni ka të drejtën që të kërkon arsyetim shtesë për propozimin e paraqitur nga propozuesi dhe ka të drejtën të kërkon ndihëm profesionale dhe teknike nga institucionet, individët të ndryshëm, ndihma e të cilëve do të ishte me vlerë për një punë të suksesshme dhe vendim të drejtë.

DISPOZITAT KALIMTARE-PËRFUNDIMTARE

Neni 12.

12. 1 Për implementimin (zbatimin) e kësaj Rregullore do të kujdeset ekzekutivi i Komunës në Suharekë.

12. 2 Kjo rregullore mundë të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi komunal në Suharekë.

12. 3 Pas Miratimit nga Kuvendi i Komunës, kjo rregullore hynë ne fuqi 15 ditë pas dërgimit në MAPL-në, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

Kryesuesi i Kuvendit

Vesel Maliqaj

01-Nr-16-5820
Data 29.09.2011